



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
SPITALI RAJONAL SHKODER

Nr. _____ prot.

Shkoder, me _____.____.2023

MIRATOHET
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SENAD HALLUNAJ

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Me date 07.09.2023 njesia e prokurimit e perbere nga Brixhilda Lazri, Olsi Ramja ,Gledi Urovi te ngritur me urdher prokurimi nr 41 date 07.09.2023 në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Shkoder** harton proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit **Cmontim,transportim dhe montimin e aparaturave mjekesore, e ndarë në 2 lote,**

Lot 1 - Cmontim,transportim dhe montimin e Mamografise

Me kod(CPV **Shërbimet te ndryshme 98300000-6** me fond limit **740,000 (shtateqind e dyzet mije) lek pa tvsh** “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, pasi fondi limit eshte nën kufirin e ulët monetar per sherbime.kjo lidhur me fondin e Përlllogaritur dhe specifikimet perkatese eshte bere me shkresen me nr 1553/4 prot date 12.06.2023 per Cmontimin,transportimin dhe montimin e Mamografise .

Njesia e prokurimit lidhur me proceduren ka hartuar kriteret me përmbajtje si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituara.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës është **14,800**(katërmbëdhjetë mijë e tetëqind) **lekë**.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

✓ Nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoritetet ose

entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ***Certifikaten ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”*** ose ***ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”***, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe është e percaktuar në pikën b) dhe c) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejme të percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2020 , 2021 dhe 2022**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratave të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, **Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për

Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3 Aftesi teknike dhe profesionale te njejte per secilin lot:

2.3.1Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të lotit për të cilat oferton

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3(*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga date e zhvillimit të tenderit, për punonjësit si më poshtë:

- 2(dy) Inxhinierë/Specialistë të çertifikuar për Çmontim, transportim dhe montim për të cilin duhet të paraqitet:

- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore(formularet E-sig 025) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit per inxhinierin bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.
- Kontrate pune te vlefshme gjate periudhes se ekzekutimit te kontrates.
- Diplomat perkatese
- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre per pajisje mjekesore sipas objektit të prokurimit.
- CV-ja.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi:Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Nga eksperiencat e mëparshme ka rezultuar se ky numer inxhinieresh ka qenë mjaftueshëm pasi nuk ka patur problematika lidhur me ofrimin e shërbimit ndër vite si dhe ky numër nuk kufizon konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes **Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)**, për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet te jete original ose kopje e perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshem ne momentin e hapjes se ofertave.

Argumentimi:Ky kriter vihet në përputhje me piken 1 te nenit 77(*aftësia teknike*) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.3.4 OE duhet të paraqesë deklarate ku garanton se në rast të shpalljes fitues, pajisjet që do të Çmontohen, transportohen dhe montohen, të gjitha punimet do të bëhen në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuar në DST, si dhe këto pajisje duhet të jenë në gjendje të plotë pune në momentin e dorëzimeve të punimeve.

Argumentimi: Kriteret e vendosura ne piken 2.3.4 jane vendosur ne perputhje me nenin 36 dhe neni 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ne nenin 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“,i ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim

ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik”, perllogaritjen e fondit limit me nr 1553/4 prot date 12.06.2023 per Cmontimin,transportimin dhe montimin e Mamografise.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Cmontim,transportim dhe montimin e aparaturave mjekesore nga ambientet e godines se Poliklinikes per tek ambientet e Spitalit Rajonal Shkoder e ndarë në 2 lote,

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga prodhuesi / MAH / ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) për të garantuar shërbim cilësor, të sigurt dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi të jetë i vlefshëm. Autorizimi duhet te jetë origjinal i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.

Kompania e autorizuar duhet të jetë e çertifikuar me ISO 9001: 2015 ose ekuivalente të vlefshme.

Kompania prodhuese të jetë e çertifikuar me ISO 13485 ose ekuivalente të vlefshme.

Kompania të ketë të paktën dy inxhinier të çertifikuar për cmontim, transport dhe montimin për pajisje mjekësore.

Kompania të jetë e autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

Loti 1 – Çmontim,transportim dhe montimin te Mamografise

SPECIFIKIMET TEKNIKE :

Nr.	Nr. Iventari	Emertim i Pajisjes	Modeli	Prodhues
1	35484	Mamografi	Image- 3 DL	Giotto

Detyrat:

- Te cmontohet ne ambientin aktual ne Poliklinike,nxjerrjen nga dhoma me transpalete dhe me fuqi punetore, ngarkimin me vinc ne kamionin qe e transporton.
- Hapi I dyte eshte montimi ne ambientet e Spitalit Rajonal Shkoder ku perfshin shkarkimin e uniteve nga kamioni me vinc,transporti me transpalete deri ne ambientin e dedikuar,montimin e uniteve perberese dhe kalibrimi I paisjes dhe vendosja ne funksion te rregullt pune
Mendojme qe ky proces do te ishte me I sakte te kryhej nga operatori ekonomik dhe jo nga personeli I SRSH.
Motivet per te cilat kemi nje mendim te tille jane si me poshte:

- Sado kujdes te tregojme ne procesin e cmontimit te uniteve mund te kemi dhe aksidente si psh demtimi I ndonje fishe. Ne cmontimin e paisjes ne mund te ndajme vetem pjesen e kontrollit te paisjes (workstation) nga paisja qe perfshin harkun me llampen dhe dedektorin. Operatori ekonomik duhet te ndaje nga paisja dhe pjesen e llampes dhe dedektorin duke e bere me te sigurt transportin e saj.
- Ne procesin e ngarkimit ne kamion operatori duhet te kete mjetet e pershtateshme si transpalete dhe vinc. Gjate transportit per ne SRSH rreziku qendron qe nga vibrimet e kamionit dhe bumet qe hasen ne rruge te kete levizje ose shkeputje te ndonje komponenti ne paisje.
- Operatori duhet te mbaje garanci dhe ne rast te demtimit te paisjeve gjate transportit.
- Montimi ne ambjentet e SRSH I aparatit do te ishte me I sakte nga operatori ekonomik,kjo pasi mbas montimit te paisjes Operatori duhet te fshije erroret e mundeshme qe mund te shfaqe paisja gjate transportit dhe duhet te beje kalibrimin e saj
- Kujtojme qe paisja pervec pjeses se paisjes me llampen+detektorin dhe workstation-it ka dhe dy monitore nje kompjuter me program te integruar per manipulimin e imazheve dhe nje printer filmash.
- Edhe ne transportin e tyre duhet treguar kujdes sidomos te printer te filmave pasi levizja e ndonje rruli,fishe apo skedes cpu do ta nxjerre jashte funksioni.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: “Spitali Rajonal Shkoder”.

Afati i lëvrimit të shërbimit është 1 muaj nga nënshkrimi i kontrates.

NJËSIA E PROKURIMIT:

- **Brixhilda Lazr** - Juriste/Spektori i Planifikim Prokurimeve
- **Olsi Ramja** - Sp/Spektorii Planifikim Prokurimeve
- **Ing.Gledi Urovi**- P/Spektorit Menaxhimit te Teknologjise